



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



E K S T R A K T

I procesverbalit të mbledhjes inauguruese të Komitetit për Komunitete,
mbajtur më 16.03.2022, duke filluar në orën 10:00.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Bersant Beka, drejtor i Administratës së Komunës së Prishtinës, me këtë

R E N D D I T E :

1. Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Komunitete.

Bersant Beka theksoi se duke e ditur që ky Komitet është i përhershëm, por edhe duke i njojur procedurat e zgjedhjes së kryesuesit, lus kryetarin e Komunës, z. Përparim Rama, ta marrë fjalën.

Përparim Rama, Kryetar i Komunës, i përshëndeti të pranishmit, duke u premtuar përkrahjen e tij maksimale, por njëkohësisht kërkoi prej të pranishmëve angazhim dhe punë të mirëfilltë, efikasitet në përpilimin e politikave për ngritjen e mundësive për komunitetet, pasi që Prishtina është e barabartë për të gjithë.

Ai u shpreh se këtë komitet e sheh si një komitet me rëndësi shumë të madhe që Prishtina të jetë ajo që duhet të jetë, pra e njëjtë për të gjithë, sepse nëse secili qytetar nuk e ndien veten të barabartë aty ku jeton, atëherë nuk e kemi Prishtinën si duhet.

Ai u shpreh se nëse gjatë punës së këtij komiteti hasni në çfarëdo pengese, unë do të jem përkrahësi më i madh për hapjen e mundësive për me e krijuar hapësirën dhe platformën për një Prishtinë me të cilën do të mburremi të gjithë, ku do të jemi të barabartë të gjithë dhe do ta shfrytëzojmë potencialin e saj në mënyrë të barabartë për të gjithë e që mundësitet janë të mëdha.

Betim Abdullahu, duke i përshëndetur të pranishmit, i informoi ata lidhur me punën dhe bashkëpunimin e ZKKK-së me të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete, sidomos me komunitetet jo shumicë, ku çdo herë kemi mirëpritur të gjitha propozimet, projektet, si dhe

Faqe 1 nga 2

kërkесат që kanë bërë, ashtu që ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe më tutje sikurse që ka qenë deri më tanë, do të mundohemi ta shtyjmë çdo proces të këtij komitetit.

Ai në vazhdim bëri edhe prezantimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete, ku shumica prej tyre ishin ish-anëtarë të këtij komiteti në mandatin e kaluar, përvèç një ndryshimi tek komuniteti ashkali dhe një anëtar i cili vjen nga Kuvendi i Komunës.

Bersant Beka theksoi se, sa i përket propozimit të kryesuesit për Komitetin për Komunitete ne mund të japim propozime, mirëpo meqë është me rotacion, atëherë kësaj radhe i takon që kryesuesi të jetë nga radhët e komunitetit boshnjak.

Atëherë, për kryesueset të Komitetit për Komunitete u propozua znj. Mirsada Behluli, ku dhe njëzëri u miratua propozimi që kryesuesja e Komitetit për Komunitete të jetë nga komuniteti boshnjak.

Mirsada Behluli i falënderoi të pranishmit për besimin e dhënë. Ajo premtoi se do të ofrojë bashkëpunim për të promovuar të drejtat e të gjitha komuniteteve, ashtu siç është vepruar edhe në mandatin e kaluar.

Klaudia Mula, duke e përgëzuar znj. Behluli për besimin e dhënë, tha se tanë duhet të zgjidhet edhe zëvendëskryesuesi i Komitetit.

Për zëvendëskryesues të Komitetit për Komunitete u propozua znj. Elmire Nikçi - Rexha. Njëzëri u miratua propozimi i dhënë, që znj. Elmire Nikçi - Rexha të jetë zëvendëskryesuese e Komitetit për Komunitete.

Elmire Nikçi - Rexha duke falënderuar të pranishmit për besimin e dhënë, theksoi se do të bashkëpunojmë edhe më tutje, ashtu siç ka ofruar bashkëpunim edhe në të kaluarën. Të gjitha kërkësat, brengat, propozimet dhe projektet që do të paraqiten këtu për shqyrtim, do të përcillen në Kuvendin e Komunës.

Nenad Miladinoviqi duke i përgëzuar dy zonjat e posazgjedhura, njëra kryesuese, ndërsa tjetra zv. kryesuese e Komitetit për Komunitete, i informoi të pranishmit lidhur me punën dhe bashkëpunimin e Komitetit me të gjitha organet kompetente në nivel lokal dhe atë qendror. Ai uroi që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Slavica Stoliqi duke i përshëndetur të pranishmit, shprehu fjalë miradije lidhur me punën e Komitetit për Komunitete. Ai uroi punë të mbarë për Komitetin, duke premtuar vazhdimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit të Komitetit për Komunitete, ashtu siç ka qenë deri më tanë.

Kryesuese e Komitetit për Komunitete u zgjodh znj. Mirsada Behluli, kurse zëvendës kryesuese e Komitetit znj. Elmire Nikçi - Rexha.

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesuese e Komitetit për Komunitete
Mirsada Behluli

Faqe 2 nga 2

